

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Kamenicë, përmes gjyqtarit, **Sadri Krasniqi**, me sekretaren juridike **Resmije Krasniqi**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës **Milica Miomir Iliq** nga fsh.Shillovë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 8.1, lidhur me nenin 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, paragraf.1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, e në bazë të nenit 9,73,74, 195 dhe 199 të Ligjit për kundërvajtjet, më **09.11.2012**, horto

A K T V E N D I M

E pandehura **Milica Miomir Iliq**, e lindur më 14.09.1990 në Vrajë, këshilltare në Asamblenë komunale në Kamenicë, e martuar, nënë e një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjesë së mesme ekonomike, e padënuar për kundërvajtje, nuk është nën hetime, me vendbanim të përhershëm në fsh.Shillovë, komuna e Gjilanit,

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse si zyrtare e lartë publike, këshilltare në Asamblenë Komunale në Kamenicë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, në Agjencinë Kundër Korrupsionit,

-me ç'rast e pandehura ka shkaktuar kundërvajtje nga neni 8.1, lidhur me nenin 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, paragraf.1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, andaj në bazë të dispozitave të të njëjtit ligj, e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 9 të Ligjit për kundërvajtjet,

D Ë N O H E T

Me të holla në shumë prej **400 €**, (Katërqindë euro) të cilin dënim e pandehura është e obliguar ta arkëtoj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën, dënimim me të holla do t'i zëvendësohet më dënim burgu në kohëzgjatje prej **26 ditësh**, duke logaritur një ditë burgu 15 € .



Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor, në afatin e lartëcekur, të arkëtoj shumën prej 5 €. Dënimin dhe paushallin gjyqësor e pandehura e arkëton në këtë gjykatë .

Me aktvendim të njoftohet e pandehura dhe parashtruesi i kërkesës .

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën nr. 01-2330/12, të parashtruar më 18.07.2012, ka propozuar që kundër të pandehurës **Milica Miomir Iliq** nga fsh.Shillovë, të fillohet dhe shtjellohet procedura kundërvajtëse, për shkak të kundërvajtjes nga neni 9, lidhur me nenin 5 dhe 6, paragraf.1.3, e sanksionuar sipas nenit 17, paragraf.1.3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, të shpallët fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata vlerësoi kërkesën dhe pas shqyrtimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoj se kërkesa është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar séancë gjyqësore për shqyrtim kryesor kundër të pandehurës më 31.10.2012, në të cilën séancë e pandehura gjatë paraqitjes së mbrojtjes së saj deklaroi se përherë të parë po dëgjon se si këshilltare e Asamblesë Komunale, është e obliguar që të deklaroj pasurinë, sepse prej askujt nuk është njoftuar më parë. Ndërsa nënshkrimin në regjistrin, në të cilin zyrtarët komunal kanë nënshkruar se kanë pranuar njoftimin për deklarimin e pasurisë, nuk e pranon si të vetin, duke ofruar si provë nënshkrimet e saj të vëna gjatë prezencës së saj në seancat e Asamblesë Komunale. E pandehura në vazhdim thekëson se më 24 janar 2012, ka lindur djalë, dhe gjatë asaj kohe më tepër është marrur me punët rreth përkujdesjes për te, ndërsa në séanca të Asamblesë komunale, zakonisht ka prezentuar vetëm në fillim sa për t'u nënshkruar. Edhe përkundër faktit se e pandehura nuk e pranon fajsinë, në fund të deklaratës së saj kërkon prej gjykatës, që nëse eventualisht gjenë prova dhe e shpallë fajtores, me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh faktin se nuk ka qenë në dijoni se duhet deklaruar pasurisë, se gjatë asaj kahe ka lindur një djalë dhe i është dashur që të kujdeset për te, si dhe nga të ardhurat mujore që merrë si këshilltare komunale në shumën prej 200 € , siguron ekzistencën e saj dhe të familjesë.

 REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA ANTI-KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Detyr. Dep. DPK/DMP	Nr Prot Str Prot Prot No. 03-159/2013	Data 02 25-01-2013

Me qëllim të vërtetimit dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë procedurës janë dëgjuar edhe dëshmitarët; Dëshmitari **Fisnik Kastrati**, zyrtar juridik i Shërbimeve publike në Kamenicë, njëherit personi kontaktues me Agjencinë Kundër Korrupsionit, deklaroi se menjëher pas marrëjes së formularëve prej agjencionit, në të dy gjuhët i ka njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publikë, të cilët sipas ligjit janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë, më 27.02.2012, ku si dëshmi ekzistojnë nënshkrimet e zyrtarëve që kanë pranuar njoftimin me shkrim dhe më 20.03.2012, njoftimin me shkrim i a ka bashkangjitur materilit për séancën e kuvendit. Dëshmitarja tjetër **Valentina Dalipi**, zyrtare administrative për punë të Asamblesë Komonale, deklaroi se gjatë séancës së Asamblesë komunale, i ka dorzuar njoftimin të gjithë këshilltarëve komunal, të cilët ishin prezent, ndërsa, pasi që Milica Iliq nuk ishte prezent, njoftimin ia ka dhënë prindërit, babait të saj Miomir Iliq, i cili është punëtorë në administratën komunale në Kamenicë. Ndërsa dëshmitari **Miomir Iliq**, gjatë dhënjes së dëshmisë së tij në gjykatë deklaroi se nuk është e vërtetë se ai ka pranuar njoftimin për deklarimin e pasurisë për vajzën e tij Milicën, sepse në të kundërtën nuk ka pasur kur far arsye që njoftimin të mos ia dorzoi Milicës. Po njashtu, lidhur me rastin në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar edhe **Enis Sadiku**-zyrtar i lartë për mbikqyrjen e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili në séancën gjyqësore të mbajtur më 30.10.2012, deklaroi se pasi që zyrtarja e lartëcekur nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë në afatin ligjor, kundër të njejtës kanë parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse.

Gjykata vlerësoi mbrojtjen e parashtruar nga e pandehura, dhe dëshmitari Miomir Iliq, por nuk i kushtoi besim ngase të njejtat si të tilla ishin të pa bazuara dhe jo bindëse, të përgaditura me qëllim të shmangjes nga përgjegjësia, sepse me rastin e krahasimit të nënshkrimit në formularin me të cilin zyrtarët komunal kanë konfirmuar se kanë pranuar njoftimin për deklarimin e pasurisë, me nënshkrimin për ardhëvajtjen në punë të punëtorëve të administratës komunale, kjo shifet se babai i të pandehurës Miomiri e ka pranuar njoftimin për deklarimin e pasurisë. Ndërsa dëshmitë e parashtruar nga ana e dëshmitarëve të tjerë në tërësi i përfilli dhe i kushtoi besim të plotë ngase të njejtat sa i përket rrëfimit për kundërvajtjen e shkaktuar ishin mjaftë bindëse, të logjikshme dhe në pajtushmëri të plotë me pretendimet e kërkesës dhe provat materjale të bashkangjitura në kërkesë. Kështu gjykata duke e vlerësuar drejtë mbrojtjen e të pandehurës, dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dhënat tjera në kërkesë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike dhe konstatoi se e pandehura Milica Iliq si zyrtare e lartë publike, këshilltare në Asamblesë Komonale në Kamenicë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, andaj gjykata bëri rikualifikimin e kundërvajtjes dhe gjeti se në rastin konkret në veprimet e të pandehurës ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga dispozitat e nenit 8.1, lidhur me nenet 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr.04/L-050, për të cilën kundërvajtje gjykata të pandehurën e shpalli fajtoreshë dhe e dënoi me të holla në shumën prej 400 €.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të pandehurës për kundërvajtjen e kryer, gjykata vlerësoi rrethanat të cilat në kuptim të nenit 7 të Ligjit për kundërvajtjet, ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, andaj për këtë rast si rethana lehtësuese pati parasysh, pasojën e veprës kundërvajtëse, se e pandehura është e moshës së re dhe nënë e një djali të vogël, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se ndaj saj nuk zhvillohet procedurë tjetër kundërvajtëse, pakujdesinë e saj që me kohë ta deklaroi pasurinë për faktin se këshilltarët komunal sipas ligjit, këtë vit për herë të parë janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë, si dhe faktin se nga të ardhurat mujore që merrë si këshilltare komunale në shumë prej 200 €, siguron ekzistencën e saj dhe të familjesë Duke vlerësuar se në të kundërtën shqiptimi i ndonjë dënimi më të lartë në të holla, do të vështëronte gjendjen ekonomiko -sociale të saj dhe familjesë. Andaj gjykata vlerësoi se edhe me shqiptimin e dënimit në të holla në shumën si në dispozitiv, do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të pandehurës që në të ardhmën të mos kryej kundërvajtje të këtuillë apo të ngajshme. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit për kundërvajtjet, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit bëri zbutjen e dënimit të përcaktuar me ligj për këtë kundërvajtje.

Vendimi për paushallin gjyqësor është shqiptuar në bazë të nenit 109 të Ligjit për kundërvajtjet
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË KAMENICË

Më 09.11.2012

GJYQTARI
Sadri Krasniqi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij

<http://maps.google.com/maps?hl=en&tab=wp> për mesazh në adresën e kësaj gjykate.

1/24/2013